



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

VENDIM

Nr. 8, Datë 07.11.2014

PËR

MIRATIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESAVE PËR LEJE
NDËRTIMI

Në mbështetje të nenit 28 të Ligjit nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, Vendimit nr. 877, datë 03.10.2013 të Këshillit të Ministrave “Për përbërjen e Këshillit Kombëtar të Territorit” dhe Vendimit nr. 1 datë 22.08.2014 “Për harmonizimin e instrumenteve të planifikimit vendor në funksion të ndarjes së re administrativo – territoriale”, me propozimin e Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesave për leje ndërtimi deri në miratimin e Projekt-Vendimit “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, sipas pikës 2 të këtij vendimi.
2. Pas marrjes së konfirmimit të përputhshmërisë nga Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, për zhvillimet që përfshihen në rastet përjashtimore të Vendimit Nr. 1 datë 22.08.2014 të KKT-së “Për harmonizimin e instrumenteve të planifikimit vendor në funksion të ndarjes së re administrativo – territoriale”, bashkitë dhe komunat mund të vijnë me shqyrtimin dhe miratimin e kërkesave për leje ndërtimi, sipas Formularëve Tip të Shtojcës nr. 2 të VKM-së nr. 502, datë 13.07.2011 “Për miratimin e rregullores uniforme të kontrollit të zhvillimit të territorit”.
3. Ngarkohet Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit dhe Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI


EDI RAMA



ZËVENDËS KRYETARE E KKT

EGLANTINA GJERMENI

MINISTËR I ZHVILLIMIT URBAN DHE TURIZMIT



SEKRETARE E KKT

ADELINA GRECA

DREJTORE E AGJENCISË KOMBËTARE TË PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT

